



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3186/2 prot

Datë 26.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-89259-11-30-2023, me objekt: “*Blerje artikuj te ndryshem ushqimor (shkolla Speciale 3 Dhjetori dhe Konvikti i shkolles Artistike)*”, me fond limit 2,436,275 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “El-Gjo 2006” SHPK, me NIPT (J66902033R), me adresë: Lagja “Tre Heronjt”, Rruga “Pal Engjëlli”, Zona kadastrale 8593, Nr.pasurie 10/630, 4001, Shkodër
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër, me adresë: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK, me NIPT (L61725018G), me adresë: Lagja “Kashar 2”, Rruga “Mullishtër”, godinë 1-katëshe, nr.pasurie 4, Zona Kadastrale 2105, Tiranë

Në datën 22.12.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 3186 prot., datë 22.12.2023 e operatorit ekonomik “El-Gjo 2006” SHPK për procedurën e prokurimit

“Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-89259-11-30-2023, me objekt: *“Blerje artikuj te ndryshem ushqimor (shkolla Speciale 3 Dhjetori dhe Konvikti i shkolles Artistike)”*, me fond limit 2,436,275 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet për të cilat operatori ekonomik ankimues “El-Gjo 2006” SHPK me anë të ankesës me nr. 3186 prot., datë 22.12.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë operatori ekonomik ankimues pretendon si më poshtë:

“[...]

*Duke u bazuar në këtë pikë ne e quajmë të kualifikuar jo korrektësisht si fitues operatorin ekonomik SEAD*SGS dhe kërkojmë rikontrollim të dokumentacionit vërtetues për ofertën anomalisht të ulët me qëllim verifikimi ku nëse ka mangësi të refuzohet ky operator dhe të vazhdojë procedura me operatorin tjetër ekonomik në radhë.”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 26.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri